



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 223 Prot

Tiranë, më 21.02.2020

V E N D I M

Nr.24, datë 21.02.2020

“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së procesit të rekrutimit dhe transferimeve në shërbimin civil, në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative gjatë administrimit të shërbimit civil, në lidhje me procesin e rekrutimeve dhe transferimeve në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për periudhën 2017 – 2019,

VËREJ SE

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me urdhrin nr. 60, datë 31.07.2019, “Për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të rekrutimit dhe transferimeve në shërbimin civil, në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit”, ka vendosur fillimin kryesisht të verifikimit të rasteve të emërimeve dhe transferimeve në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të kryera nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për periudhën 2017-2019.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, nga grupi i punës, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Për realizimin e këtij procesi, fillimisht u njoftua institucioni me shkresën nr. 1409/1 prot., datë 31.07.2019, “Njoftim për fillimin e verifikimit të ligjshmërisë së procesit të rekrutimit dhe transferimeve në shërbimin civil, në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” dhe u

administrua dokumentacioni shkresor, për të cilin është mbajtur “Akt – konstatimi”, i datës 10.09.2019. Nga aktet e administruara gjatë verifikimit në subjekt, rezulton se:

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), është një institucion në varësi të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i cili është krijuar dhe funksionon mbi bazën e ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 1081, datë 21.10.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, i ndryshuar.

Në momentin e kryerjes së verifikimi, rezulton se, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit funksiononte mbi bazën e strukturës së miratuar me urdhrin nr. 119, datë 10.03.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, ndryshuar me urdhrin nr. 117, datë 31.07.2018, të Kryeministrit, “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 119, datë 10.03.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”. Sipas kësaj strukture, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, organizohet në nivel qendror nga Drejtoria e Përgjithshme dhe 12 Drejtoritë Rajonale në çdo qark, konkretisht: Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë, Fier, Berat, Elbasan, Dibër, Kukës dhe Lezhë. Numri total i pozicioneve të punës është 418, nga të cilat 403 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.

Gjatë procesit të inspektimit në këtë institucion, rezultoi se, në 12 raste, pozicionet e punës, të cilat në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar janë vende të lira, janë plotësuar nga studentë të ekselencës në zbatim të Vendimit nr. 766, datë 26.12.2018, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil, për vitin 2019”, të Këshillit të Ministrave, me të cilët institucioni ka lidhur kontratë të përkohshme pune me afat kohor 1 vit, në zbatim të pikës 12, të po këtij vendimi.

Duke analizuar me radhë problematikat e evidentuara gjatë verifikimit në subjekt, Komisioneri konstatoi se 2 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi emërimi i punonjësve në këto pozicione nuk është realizuar nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur. Konkretisht bëhet fjalë për pozicionet e punës të paraqitura si më poshtë:

1. *****, emëruar me aktin nr. 4327/1, datë 05.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në pozicionin e punës “Inspektor”, në Sektorin e Koordinimit të Inspektorëve në PIK, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së;

2. *****, emëruar me aktin nr. 4328/1, datë 05.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, në pozicionin e punës “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore në Drejtorinë Rajonale të AKU-së Qarku Tiranë.

Komisioneri evidenton se, aktet e mësipërme të emërimit, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht, kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me këtë rregull, në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, është absolutisht i pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën për pozicionet e nivelit ekzekutiv, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 111, të po këtij ligji, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore.

Më tej, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të AKU, duhet t’i përfshijë këto pozicione në planin vjetor për pranimin në shërbimin civil, me qëllim që njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike të realizojë plotësimin e tyre me anë të procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Nga verifikimet e kryera në institucionin e AKU-së dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, Komisioneri konstaton se, për periudhën e verifikimit janë kryer transferime (komandime) të përkohshme, të cilat rezultojnë të jenë kryer në kundërshtim me kërkesat e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konkretisht bëhet fjalë për nëpunësit si më poshtë:

1. *****, i cili është emëruar fillimisht me aktin nr. 1631/2, datë 14.05.2019, në zbatim të Vendimit nr. 766, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, *“Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil, për vitin 2019”* në pozicionin *“Inspektor”*, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Durrës, me urdhër të brendshëm nr. 1631/2, datë 14.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, ky punonjës është transferuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU.
2. *****, nëpunës civil në pozicionin *“Inspektor”*, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Dibër, me urdhër të brendshëm nr. 4015, datë 27.06.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm është transferuar pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë.
3. *****, nëpunës civil në pozicionin *“Inspektor”*, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Fier, me urdhrin nr. 4017 prot., datë 27.06.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, është transferuar përkohësisht pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë.
4. *****, nëpunës civil në pozicionin *“Inspektor”*, në Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore pranë AKU, Qarku Berat, me urdhrin nr. 4016 prot., datë 27.06.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm ky punonjës është transferuar pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë.
5. *****, nëpunës i emëruar në zbatim të Vendimit nr.766, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, *“Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil, për vitin 2019”*, në pozicionin *“Inspektor”*, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë, me urdhrin nr. 2885/1 prot., datë 10.06.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm ky punonjës është transferuar pranë së njëjtës Drejtori në pozicionin e punës *“Specialiste në Sektorin e Laboratorit”*.
6. *****, nëpunës civil, në pozicionin *“Inspektor”*, në Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë. Me urdhrin e brendshëm nr. 5330 prot., datë 06.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, ky punonjës është transferuar përkohësisht në pozicionin *“Inspektor”* në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, pranë Drejtorisë së AKU, Qarku Korçë.
7. *****, nëpunës civil, në pozicionin *“Inspektor”*, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë, me urdhrin e brendshëm nr. 1803 prot., datë 25.03.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, ky punonjës është transferuar Inspektor OJSH në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, Qarku Korçë.

8. *****, nëpunës i emëruar në zbatim të Vendimit nr.766, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil, për vitin 2019”, në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale, Qarku Durrës, me urdhrin nr. 1744/2 prot., datë 21.03.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, ky punonjës është transferuar (caktuar) përkohësisht në pozicionin Specialist në Sektorin e Shërbimeve Laboratorike në AKU, Qarku Durrës.
9. *****, nëpunës civil, në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Durrës, me urdhrin e brendshëm nr. 6158 prot., datë 30.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, ky punonjës është transferuar Inspektor (Veteriner) në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar pranë AKU, Qarku Durrës.

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve të institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, rezulton se për punonjësit e evidentuar më sipër, pagesa për pozicionin e punës kryhet nga institucioni ku ata kanë emërimin, ndërsa listëprezenca hartohet nga institucioni (*drejtoria rajonale*), ku sipas urdhrit të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, janë transferuar të ushtrojnë detyrën e tyre.

Aktet e transferimit të përkohshëm për punonjësit e mësipërm, të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, janë akte të cilat vijnë në kundërshtim me kërkesat e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili në pikën 1 të tij, përcakton se nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në interes të institucionit, me kërkesë të institucionit, drejtorisë së interesuar, ose të njësisë së burimeve njerëzore, duke përcaktuar dhe kohëzgjatjen e këtij transferimi, i cili duhet të jetë deri në 6 muaj gjatë 2 viteve.

Njëkohësisht, në zbatim të pikës 5, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, vendimi për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil duhet të miratohet nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike. Nga verifikimi i dosjes personale të nëpunësve të mësipërm dhe nga komunikimi me njësinë e burimeve njerëzore, rezultoi se Autoriteti Kombëtar i ushqimit nuk i është drejtuar njësisë përgjegjëse (DAP), për të kërkuar miratimin në lidhje me procedurat e transferimit për punonjësit e mësipërm.

Sa më sipër, mosrespektimi i procedurës së sipërcituar, përcakton se aktet e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për transferimin e përkohshëm për 9 punonjësit e mësipërm, janë akte absolutisht të pavlefshme, kjo në kuptim të nenit 108, germa a, pika “ii”, të ligjit nr. 44, 2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të cilat nuk sjellin pasoja juridike. Në zbatim të nenit 111, të ligjit të sipërcituar, vetë organi publik, konkretisht Drejtori i Përgjithshëm i AKU, duhet të konstatojë

pavlefshmërinë absolute të akteve të mësipërme, t'i shfuqizojë ato dhe të rregullojë pasojat, duke vendosur kthimin e këtyre punonjësve në pozicionin ku ata janë emëruar nga Departamenti i Administratës Publike.

Në të ardhmen, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit duhet të kujdeset për zhvillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm sipas kërkesave të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke mbajtur parasysh:

- a) Përcaktimin në akt të afatit (*kohëzgjatjes*) të transferimit të përkohshëm, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 6 muaj, në 2 vjet.
- b) Marrjen e miratimit nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.

Njëkohësisht, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioneri konstaton se, për periudhën objekt verifikimi, 11 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit janë plotësuar me nëpunës civilë, të komanduar në mënyrë të përkohshme, me akt individual të nxjerrë nga titullari i institucionit, në pozicione pune të një kategorie më të lartë në shërbimin civil, se ajo ku ata e gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Bëhet fjalë për nëpunësit si më poshtë:

1. *****, me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorve të Biznesit në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Elbasan, është komanduar në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Elbasan”, me aktin nr. 5389/6, datë 09.01.2018.
2. *****, me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Kukës, është komanduar në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Kukës”, me aktin nr. 1401, datë 05.03.2019.
3. *****, me detyrë Specialist i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme, është komanduar në pozicionin e punës “Drejtor Drejtoria Rajonale Qarku Korçë”, me aktin nr. 2722, datë 08.05.2019.
4. *****, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, është komanduar në pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Tiranë”, me aktin nr. 2723, datë 08.05.2019.
5. *****, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, është komanduar në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU”, me aktin nr. 2724, datë 08.05.2019.
6. *****, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Sistemit të Informimit të Shpejtë dhe Mbikëqyrjes së Tregut në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, është

komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Durrës*”, me aktin nr. 2700, datë 08.05.2019.

7. *****, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Laboratorike pranë Drejtorisë Rajonale të AKU Qarku Fier, është komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Fier*”, me aktin nr. 4065/2, datë 20.11.2017.
8. *****, me detyrë Specialist i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme në Drejtorinë Rajonale të AKU Qarku Lezhë, është komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Lezhë*”, me aktin nr. 4099, datë 01.07.2019.
9. *****, me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorve të Biznesit në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Dibër, është komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Dibër*”, me aktin nr. 1823, datë 26.03.2019.
10. *****, me detyrë Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU, është komanduar në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorve të Biznesit në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU*”, me aktin nr. 1951, datë 02.04.2019.
11. *****, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit të Inspektorve në PIK në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU, është komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU*”, me aktin nr. 4622, datë 16.07.2019.

Nga sa më sipër, në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit/komandimit për punonjësit e mësipërm në pozicionet aktuale, janë nxjerrë në kundërshtim me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pasi vërehet se në rastin konkret nuk është zbatuar procedura e ngritjes në detyrë, e parashikuar në nenin 26, të po këtij ligji dhe në Kreun III, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”.

Në kuptim të nenit 108, pika i) dhe ii), germa “a” dhe “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, aktet e emërimit për punonjësit e evidentuar sa më sipër, janë akte absolutisht të pavlefshme, të cilat në kuptim të nenit 111, të po këtij ligji duhet të konstatohen si të tilla, nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Me konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit/komandimit, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, duhet të drejtojë procesin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për punonjësit e mësipërm, nga pozicioni ku aktualisht ushtrojnë detyrën dhe të

rikthejë këta nëpunës në pozicionet ku ata rezultojnë të jenë emëruar nga njësia përgjegjëse DAP.

Më tej, në vijim të kësaj analize, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pozicionet e mësipërme, të plotësuara me punonjës të emëruar me akt komandimi, duhet t'i përfshijë në planin vjetor të pranimi në shërbimin civil, duke ja komunikuar njësisë përgjegjëse DAP, me qëllim plotësimin e tyre në përputhje me procedurat e konkurrimit të përcaktuar në ligjin për nëpunësin civil.

Nisur nga problematikat e evidentuara në përmbajtje të këtij vendimi si dhe mbikëqyrjes dhe verifikimit të kryer në mënyrë të vazhdueshme pranë institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Komisioneri kërkon të theksojë se, njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, si në ato qendrore dhe në institucionet e varësisë, janë mekanizma që luajnë një rol të rëndësishëm në administrimin e shërbimit civil, rol i cili buron nga përcaktimet specifike të nenit 10, të ligjit për nëpunësin civil, e vijon me kompetencat ligjore të përcaktuara shprehimisht gjatë zhvillimit të procedurave ligjore që parashikojnë dispozitat në vijim të këtij ligji.

Pozicionimi në këtë mënyrë i këtyre njësive, në institucionet e vartësisë, i vendos ato përkrah njësive të burimeve njerëzore të ministrisë nga varet institucioni, si dhe Departamentit të Administratës Publike, në procesin e zbatimit të reformave strukturore dhe funksionale, të ndërmarra nga qeveria në kuadër të reformës së përgjithshme në shërbimin civil.

Gjatë ushtrimit të kompetencës për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, kjo njësi bashkëvepron dhe bashkërendon punët me Departamentin e Administratës Publike, si dhe me njësitë e tjera pjesë të strukturës së institucionit me qëllim që të sigurohet zbatimi i parimeve të sanksionuara në ligjin e shërbimit civil dhe të respektohen procedurat ligjore për çdo institut të tij, ndër të cilat, hartimi i planit të nevojave për rekrutim e trajnim të stafit, hartimi i përshkrimeve të punës, vlerësimet e performancës, evidentimin e karrierës së personelit pjesë përbërëse e institucionit, etj

Nga dokumentacioni i administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, nuk është evidentuar asnjë material shpresor sinjalizues nga njësia e burimeve njerëzore në institucion, për të informuar DAP apo titullarin e institucionit, me qëllim që të merreshin masat e nevojshme për rivendosjen e ligjshmërisë në institucionin e AKU-së.

Në këtë moment, duke mos anashkaluar përgjegjësinë e njësisë së burimeve njerëzore, Komisioneri vlerëson dhe faktin se, niveli i përgjegjësisë për shkeljen e ligjit në administrimin e shërbimit civil, është më i lartë tek veprimet e titullarit të institucionit, i cili ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin dhe ka kryer emërimet në pozicione të shërbimit

civil, nëpërmjet akteve të nxjerra prej tij, në kapërcim të kompetencave ligjore, duke mos respektuar procedurat e parashikuara nga ligji për nëpunësin civil edhe pse në përmbajtjen e tij, përcaktohet në mënyrë të shprehur se, emërimet e kryera në kundërshtim me këtë ligj, janë veprime juridike absolutisht të pavlefshme.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Për të rregulluar ligjshmërinë e veprimeve administrative të konstatuara me parregullsi, gjatë inspektimit të kryer në këtë institucion, për periudhën 2017-2019, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit duhet të veprojë si më poshtë:

a) Të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, 2 rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me përcaktimet e nenit 22, 23 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, që janë:

- ✓ ***** , *“Inspektor”*, në Sektorin e Koordinimit të Inspektorëve në PIK, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, emëruar me aktin nr. 4327/1, datë 05.07.2019;
- ✓ ***** , *“Inspektor”*, në Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore në Drejtorinë Rajonale të AKU-së, Qarku Tiranë emëruar me aktin nr. 4328/1, datë 05.07.2019.

Pozicionet e mësipërme duhet të konsiderohen pozicione të lira dhe njësia e meaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, t’i përfshijë në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2020, duke ja komunikuar njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.

b) Të shfuqizojë si akte administrative absolutisht të pavlefshme, të dala në kundërshtim me përcaktimet e nenit 48, të ligjit për nëpunësin civil, aktet e komandimit të përkohshëm të 9 nëpunësve civilë, si më poshtë:

- ✓ ******, transferuar në pozicionin “*Inspektor*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, me aktin nr. 1631/2, datë 14.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, nga pozicioni “*Inspektor*”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, pranë Degës Rajonale AKU, Qarku Durrës;
- ✓ ******, transferuar në pozicionin “*Inspektor*”, në Degën Rajonale të AKU, Qarku Tiranë, me aktin nr. 4015, datë 27.06.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, nga pozicioni “*Inspektor*”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Dibrë;
- ✓ ******, transferuar në pozicionin “*Inspektor*”, në Degën Rajonale të AKU, Qarku Tiranë, me aktin nr. 4017 prot., datë 27.06.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, nga pozicioni “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Fier;
- ✓ ******, transferuar në pozicionin “*Inspektor*”, në Degën Rajonale të AKU, Qarku Tiranë, me aktin nr. 4016 prot., datë 27.06.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, nga pozicioni “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore pranë AKU, Qarku Berat;
- ✓ ******, transferuar në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Laboratorit*”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Korçë, me aktin nr. 885/1 prot., datë 10.06.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, nga pozicioni “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë;
- ✓ ******, transferuar në pozicionin “*Inspektor*” në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, pranë Drejtorisë së AKU, Qarku Korçë, me aktin nr. 5330 prot., datë 06.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, nga pozicioni “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë;
- ✓ ******, transferuar në pozicionin “*Inspektor OJSH*”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, Qarku Korçë, me aktin nr. 1803 prot., datë 25.03.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, nga pozicioni “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë;
- ✓ ******, transferuar në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Shërbimeve Laboratorike në AKU, Qarku Durrës, me aktin nr. 1744/2 prot., datë 21.03.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, nga pozicioni “*Inspektor*”, në Sektorin

e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale, Qarku Durrës;

- ✓ ***** , transferuar në pozicionin “*Inspektor*” (Veteriner), në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar pranë AKU, Qarku Durrës, me aktin nr. 6158 prot., datë 30.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm, nga pozicioni “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Durrës.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të drejtojë procesin e kthimit të punonjësve të mësipërm, në pozicionet e punës ku ata rezultojnë të jenë emëruar nga Departamenti i Administratës Publike.

- c) Të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit/delegimit të përkohshëm të detyrave, për **11** nëpunësit civilë të emëruar/komanduar në pozicione pune të shërbimit civil pa respektuar procedurën e ngritjes në detyrë, të përcaktuar në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si më poshtë:

- ✓ ***** , komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Elbasan*”, me aktin nr. 5389/6, datë 09.01.2018;
- ✓ ***** , komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Kukës*”, me akti nr. 1401, datë 05.03.2019;
- ✓ ***** , komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor Drejtoria Rajonale Qarku Korçë*”, me aktin nr. 2722, datë 08.05.2019;
- ✓ ***** , komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Tiranë*”, me aktin nr. 2723, datë 08.05.2019;
- ✓ ***** , komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU*”, me aktin nr. 2724, datë 08.05.2019;
- ✓ ***** , komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Durrës*”, me aktin nr. 2700, datë 08.05.2019;
- ✓ ***** , komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Fier*”, me aktin nr. 4065/2, datë 20.11.2017;
- ✓ ***** , komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Lezhë*”, me aktin nr. 4099, datë 01.07.2019;
- ✓ ***** , komanduar në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë Rajonale Qarku Dibër*”, me aktin nr. 1823, datë 26.03.2019;
- ✓ ***** , komanduar në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo Shtazore*”

dhe Operatorve të Biznesit në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU”, me aktin nr. 1951, datë 02.04.2019;

- ✓ *******, komanduar në pozicionin e punës “ *Drejtore në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU*”, me aktin nr. 4622, datë 16.07.2019.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të drejtojë procesin e kthimit të punonjësve të mësipërm, në pozicionet e punës ku ata rezultojnë të jenë emëruar nga Departamenti i Administratës Publike.

2. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për të gjitha pozicionet e punës të evidentuara më sipër, si dhe për pozicionet e tjera, që në kuptim të ligjit aktualisht janë të lira duhet t’i përfshijë në planin vjetor të nevojave për rekrutim në shërbimin civil për vitin 2020 dhe t’ia komunikojë këtë akt Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Departamentit të Administratës Publike.
3. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e pozicioneve të lira në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
4. Institucioni i Autoriteti Kombëtar të Ushqimit dhe në veçanti njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, duhet të tregojnë kujdes që në të ardhmen të marrin të gjitha masat e nevojshme për administrimin e shërbimit civil në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, me qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, si dhe garantimin e të drejtave të nëpunësve civilë në lidhje me zhvillimin e karrierës dhe qëndrueshmërisë në shërbimin civil.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **45 ditë** nga marrja dijeni për këtë vendim. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur (AKU) dhe Departamenti i Administratës Publike, duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil,

nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

7. Për këtë vendim të njoftohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Departamenti i Administratës Publike. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e AKU, të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha